



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 95-të të mbajtur më 15.11.2023, ka miratuar sa vijon.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2968/1 nga 16.06.2023, me pretendimet për paligjshmëri të kryera nga një avokat dhe përmbarues në procedurat e falimentimit, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-2968/1 nga 16.06.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më 16 qershor 2023, një parashtrues i njohur ka paraqitur denoncim me pretendime për paligjshmëri të kryera nga një avokat dhe përmbarues në procedurat e falimentimit dhe është konstatuar lënda me numër 12-2968/1, datë 16.06.2023.

Në denoncim, parashtruesi thekson se në procedurën e falimentimit mbi /// – ///, në të cilën parashtruesi është një nga kreditorët, avokati /// dhe përmbaruesi ///, i autorizuar për të përfaqësuar interesat e kreditorët, po vepron në mënyrë tendencioze dhe joprofesionale.

Parashtruesi vlerëson se një veprim i tillë i avokatit dhe përmbaruesit është në favor të ish-drejtnesit të /// mbi të cilin është zhvilluar procedura e falimentimit, në drejtim të mundësimit të përfitimit për të.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në denoncim bëhet fjalë për pretendime që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij Vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: A.R.M.

Miratoi: B.I

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

